

EKSTRAKT NGA INTERVISTA

[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 22 maj, 2021 në Prishtinë. Me kërkesen e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]

Intervistuesja: Kur ke fillu me punu?

Narratorja: 2007-tën kom fillue herën e parë edhe mo s’e kom ndërpre beso. Po kom fillu veç niherë në javë me punu.

Intervistuesja: Çka bojshe, çfarë pune?

Narratorja: Mirëmbajtje kom punue për arsye se nuk kisha edhe qare se fëmitë e vogël, besa burri punojke, po shumë pak.

Intervistuesja: Çka punon ai?

Narratorja: Punon në kompani të sigurimeve, në “Hortikulturë”. Po atëherë kanë qenë tepër pagat e ulëta, i ka pasë kur jemi dalë na në shpi tonë 80 marka, me marka jonë konë hala, 80 marka pagë mujore. Punën e parë ma ka gjetë çika e dajës.

Intervistuesja: Qysh tregona pak.

Narratorja: Ajo ka punue vet atë punë. Edhe u takum te vëllau, fëmitë e tina e patën ditëlindjen, ditëlindjen e parë, i ka pasë dy fëmijë bineqë edhe i ka sot. Edhe ajo u konë t’u punu aty edhe u feju edhe burri vet nuk dojke. “S’kem nevojë, edhe s’ki nevojë ti me shku me punue”. Po më thotë, “A po shkon me punue, pse s’po punon ti?” “Po” thashë, “s’po di ku edhe po m’vjen shtirë me ja nisë vet”, “Jo” tha, “qe p’e thirri unë aty ku jom t’u punue edhe p’e kqyrëm e shko”. Ajo meniherë tha, “Po, bire”. E më çoi ajo deri aty, ni mujë jom shku niherë në javë, s’i kom thonë kërkuja hiç që po punoj.

Intervistuesja: Qysh ka qenë qajo ndjenja me shku te dikush që s’e ke njoftë përpara?

Narratorja: Ka qenë ni ndjenjë shumë e rondë, shumë e rondë. S'po di qysh me spjegue, sikur kur shkon ni vend sefte, sikur shtete të jashtme. S'e di, se s'jom konë asniherë, amo sikur kur shkon dikun jashtë e nuk e njeh as ambientin as... me fillue tash me hi këtu edhe me ja nisë prej zeros osht' goxha punë e rondë. Po t'u kqyr, t'u pyet ato, "Ku, qysh? A po të pëlqen qitu a qitu?" Hajt dita e parë, hajt javën tjetër kur shkova t'u fillue, t'u punue pak çdo... senet nuk o që s'i disha, po në shpi të huj edhe nuk ja u din venet po edhe ajo ke e knaqne shumë. Edhe une fillova me ja nimu shpisë pak me atë pagesë, jo që ke qaq shumë, po bajagi mirë më dalke mu se isha edhe vet në shpi tanë javën, përpos ni dite që punojsha. Pak kur din me menaxhue, duhet, duhet punë po osht', ja del diqysh.

Intervistuesja: Çka kanë qenë detyrat e tua, çka je dashtë me bo?

Narratorja: Çka kanë qenë detyrat e mia, gjithçka çka të pajsh, prej...

Intervistuesja: Hajt pak...

Narratorja: Prej xhamave, dyrë, dysHEME. Kuzhina çka ka elementet, krejt çka ka. Përpos bukë s'kom bo kurgjo edhe tjerat krejt. Kom pasë me hekuros me... krejt çka ka punë të shpisë edhe ka pasë edhe pak oborr, edhe oborin me dalë me la, po s'e kom pasë problem veç a osht' e knaqne ajo. Edhe kom dashtë me marrë paren sa ma, qysh thojnë popullorçe, sa ma hallall se kom pasë me rritë, me ushqy fëmi me qato pare.

Erdh ni shoqe e sajna ka qenë gjermane edhe më pa t'u punu i pëlqej puna tha, ajo, ka qenë nëntori tha, "Une kom me shkue në Gjermani për pushim, festat e fundivitit që jonë edhe kur të kthena a vjen edhe te une?" Tha, "Te une duhesh dy herë në javë". Thashë, "P'e provoj". M'u dhimke vajza e vogël tri vjet e lashë. A din qysh, sa mujsha me bo e me u kthye te, te vajza se hala e kom pasë tu e ushqye.

Edhe hajde u kthy ajo më thirri, shkova te ajo dy herë në javët. Ni ditë prej 9:00 deri në 16:00, ni ditë prej 12:00 deri në 16:00, po më pagujke mirë shumë. Edhe ish tepër e knaqne edhe i ka pasë fëmitë barabar me të mitë edhe ka qenë tepër e mirë. Çka i blejke vajzës vet u konë barabar me temën, çka i blejke asaj edhe temës.

Edhe punës nuk i pritojka hiç, punojsha gjithçka. Beso ajo më thojke, "Veç te ju shiptartë po shohë që fshihen xhamat çdo javë, hajde mrena, po jashta mos i fshij se apet po bjen shiu p'i bon". Kom punu aty dy vjet, gati tri, atynve ju erdh koha me shku. Edhe po më thotë, "O shumë keq po më vjen që po të lo ty tash pa punë, se ka njerëz që s'punojnë edhe kanë gjetë punë. E ti që po punon kaq shumë e kaq mirë jet pa punë".

Tha, "Po ta çoj numrin e telefonit në UNDP, aty e kam ni shoqe" tha, "niherë besoj që kanë me të thirrë veç zavendësim tani kur të kanë nevojë ata". Beso, hiç s'i besova se thashë, hajt kjo e kryen punën e vet

edhe shkon edhe për mue mo s'i bjen në mend kërkujna. Po dashti edhe ajo shumë e mirë edhe më thirrën nihere, zavëndësim ni mujë ditë. Pagesa shumë e mirë në UNDP.

Punova ni mujë ditë, deri sa u kthy ajo që ka qenë në pushim, u kthy në vend të vet, aty ju pëlqeva shumë në punë. Shumë veta tani më thojshin, "A po vjen?" Po java i kish shtatë ditë, s'kish ma shumë. Osht punë e lodhshme, s'osht lehtë, kije lloj-lloj përvoje. Ka njerëz që janë shumë të mirë, ka nejrëz me thonë të këqi, po janë, ronë m'u përgjigj amo ka edhe prej atynve. Po nashta edhe ata nuk e kanë lehtë se e marrin gjithkon e shtinë në shpi, nuk o lehtë edhe për ata, po apet ma zor osht' për neve që shkojmë e po hijmë në shpi të huj.

Tre-katër mujë bash saktë nuk e di sa, veç më doken shumë të gatë bile, kom punu ni vend në Velani, emrin s'po ja u përmendi kush jonë konë, ajo që më ka marrë ka qenë nusja, shumë e mirë, po e ka pasë vjehrrën tepër, tepër e keqe. Puna i pëlqejke tepër thojke, "Shumë mirë po punon, po shumë kadal". Po, edhe shpejt edhe mirë nuk ka. M'u dashke prej 9:00 deri 13:00, nuk kryhen punët e shpisë prej 09:00 deri 13:00 edhe me dalë, une dojsa me ja kry krejt mirë m'u doke që e zgatsha pak, pak ma shumë.

Amo, s'e kisha problem për pagesë veç le të ndahen të knaqun. E nusja më thojke, "Tepër, une nuk e di çka boj mos m'u konë ti, qaq, qaq mirë që po punon". Menxi s'přitsha me më dalë diçka e me lonë, besom se shumë me pritesë shkojsa. Ka shumë vena që punoj tash, shkoj si me shku te naj shoqe, s'e kom problem ose te motra ose... qaq jom e lirë. E kom çelësin, hi, i kryj punët, dal. Edhe mos m'i kry s'e kom problem.

"Ti qiti në ren bo çka dush," jonë shumë të mirë. Po aty jom shku tepër... Jom gëzue kur um thirrën në UNDP zavendësim, zavendësim. Po me thonë jo më vike keq shumë prej asaj nusës, që m'i thonë, "S'po muj me ardhë mo". U gëzova kur më thirrën në UNDP, edhe e lashë s'shkova mo hiç. Shumë, ni punë jo shumë e mirë për shkak se as s'ka sigurim, as s'ka pension. Nesër e len metë pa kurgjo, nuk të figuron kërkun...

Intervistuesja: Që ke punu.

Narratorja: Që ke punue diçka. E për qetasht...

Intervistuesja: Deri tash, domethonë kurrë s'ke pasë kontratë?

Narratorja: Atëherë në UNDP, po.

Intervistuesja: Po, në këto tjerat?

Narratorja: Në këto tjerat, jo.